

UDHËZIM
Nr. 7, datë 19.4.2016

**PËR VLERËSIMIN E TEKSTEVE TË REJA SHKOLLORE TË KLASËS SË PARË
DHE TË GJASHTË TË ARSIMIT BAZË, TË PËRDORURA NË VITIN SHKOLLOR
2015–2016**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Katalogu i teksteve shkollore 2015–2016 për klasën e parë dhe të gjashtë të arsimit bazë është dokumenti ku do të mbështetet vlerësimi.

2. Në këtë vlerësim do të marrin pjesë mësuesit që kanë punuar me këto tekste gjatë vitit shkollor 2015–2016 dhe këshilli i prindërve të klasës së parë dhe të gjashtë.

3. Vlerësimi do të bëhet përmes plotësimit të instrumenteve (pyetësorëve) të veçantë nga prindërit dhe mësuesit.

4. Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të përgatitin dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e procesit.

5. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të hartojë raportin përfundimtar për vlerësimin e teksteve shkollore 2015-2016 për klasën e parë dhe të gjashtë të arsimit bazë, bazuar në të dhënat e dërguara nga DAR-et.

II. VLERËSIMI I TEKSTEVE SHKOLL-ORE

II.1 Në çdo shkollë të arsimit bazë:

a) Çdo mësues, bazuar në këtë katalog do të plotësojë pyetësorin e përgatitur për mësuesin dhe do ta dorëzojë në drejtorinë e shkollës. Mësuesi që zhvillon mësim në më shumë se një shkollë, do të plotësojë dhe do të dorëzojë pyetësorin në shkollën ku ka numrin më të madh të orëve mësimore javore. Drejtuesit e shkollës të plotësojnë pyetësorin të njëjtë me atë të mësuesit, nëse ata zhvillojnë mësim në klasën e parë apo të gjashtë.

b) Këshillat e prindërve do të plotësojnë pyetësorin e përgatitur për prindërit dhe do ta dorëzojnë në drejtorinë e shkollës ku mëson fëmija.

II.2 Në çdo DAR/ZA:

a) Drejtuesi i institucionit të ngrejë komisionin për administrimin e dokumentacionit të vlerësimit (KADV) të teksteve shkollore të klasës së parë dhe të gjashtë. Numri i anëtarëve të KADV-it të jetë në varësi të numrit të mësuesve që ka DAR/ZA-ja. Anëtarë të komisionit të jenë vetëm punonjësit e sektorit të kurrikulës, të sektorit të kualifikimit dhe cilësisë dhe drejtorë të shkollave. Anëtarët e KADV-it të nënshkruajnë një deklaratë përgjegjësie individuale për mënjanimin e konfliktit të interesit dhe për mbarëvajtjen e procesit.

b) Leximi i pyetësorëve dhe regjistrimi i rezultateve në formularët përmbledhës të bëhen në mënyrë të hapur, menjëherë pas marrjes në dorëzim të materialeve të sjella nga të gjithë drejtorët e shkollave. Të dhënat e këtyre pyetësorëve të hidhen nga DAR/ZA-ja në formatin elektronik dhe të dërgohen në MAS.

c) KADV-i në DAR/ZA të sistemojë të gjithë pyetësorët të ndarë, veç ata për mësuesin dhe për prindin dhe sipas klasave (kl. 1 dhe kl. 5) dhe t’ia dorëzojë me procesverbal Komisionit për Administrimin e Dokumentacionit të Vlerësimit në MAS.

II.3 Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit:

a) Të ngrihet Komisioni për Administrimin e Dokumentacionit (KAD);

b) KAD-i të marrë në dorëzim materialet e ardhura nga DAR/ZA-të; të plotësojë tabelën

përfundimtare të rezultateve dhe t'i paraqesë ministrit raportin përfundimtar për procesin;

c) Të gjithë pyetëtorët e mësuesve dhe të këshillave të prindërve, formularët përmbledhës e procesverbalet e KADV-ve të DAR/ZA-ve dhe raporti përfundimtar i KAD-it të ruhen për një vit.

III. KONFLIKTI I INTERESIT

a) Punonjësve të MAS-it dhe të institucioneve të varësisë, përfshirë titullarët e punonjësit e DAR/ZA-ve dhe drejtuesit e shkollave, u ndalo-het ndikimi në procesin e vlerësimit të teksteve shkollore nga mësuesit dhe prindërit.

b) Mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, që janë autorë/bashkautorë të teksteve, nuk marrin pjesë në këtë vlerësim.

c) Punonjësit e DAR/ZA-ve, autorë/bashk-autorë tekstesh shkollore nuk mund të jenë anëtarë të KADV-it.

d) Gjatë procesit të vlerësimit të teksteve shkollore të klasës së parë dhe të gjashtë, nuk lejohet asnjë veprimtari e shtëpive botuese, që ka për qëllim publicitetin e teksteve të tyre.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Teknologjisë Infor-macionit dhe Komunikimit, Drejtorja e Shërbi-meve të Brendshme, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore.

Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë udhë-zim, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla